

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan CELIBASHI**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja**
- **Të Tjerë: Z. A. Olldashi, Z. R. Keta, Znj. A. Qefalia
Znj. G. Canollari, Z. E. Mahmuti, Z. J. Dedej, Znj. A. Dervishaj, Znj. O. Abdia
KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë në seancën e sotme kemi në rendin e ditës këto çështje: Projektvendim “Për caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet e 14 Majit 2023”. Kemi pastaj tre çështje që lidhen me raportimin e institucioneve publike. Një që ka të bëjë me “Shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, bazuar në kërkesa dhe dënuncime indicie të paraqitura nga disa organizata të shoqërisë civile”. Pastaj kemi “Vlerësim e raportimeve të veprimtarive të institucioneve publike për periudhën 17 shkurt – 23 shkurt 2023”. Pika tjetër ka të bëjë me periudhën 24 shkurt – 2 mars. Pastaj në pikën pesë të rendit të ditës kemi “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin si subjekte zgjedhore për këto parti politike: “Partia Socialdemokrate”,

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

“Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, “Partia e Gjelbër”, “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, “Partia Ora e Shqipërisë”, “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, “Aleanca Arbnore Kombëtare”, “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, “Partia Emigracioni Shqiptar”, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, “Partia Qytetare Shqiptare”, “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen MEGA”, “Partia Republikane Shqiptare”, “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, “Partia Shqiptare Atdheu”, “Partia Uniteti Kombëtar”, “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, “Lëvizja Punëtore Shqiptare”, “Nisma Thurje”, “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, “Balli Kombëtar Demokrat”, “Partia Konservatore”, “Lëvizja e Re”, “Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë”, “Aleanca Demokracia e Re”, “Partia Balli Kombëtar”, “Partia Demokracia Sociale”, “Personat me Aftësi të Kufizuar”, “Aleanca Demokratike Shqiptare”, “Lëvizja e Legalitetit”, “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, “Bashkimi Liberal Demokrat”, “Ardhmëria Shqiptare”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare” “Partia Fryma e Re Demokratike”, “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European,” “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, “Fronti i Majtë”, “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”. Janë 42 kërkesa për regjistrimin e partive politike.

Pastaj kemi në rendin e ditës shqyrtimin e kërkesave për disa Komiteteve Nismëtar, regjistrimin e kandidatit mbështetur nga zgjedhësit. I pari ka të bëjë me paraqitjen e zotit Eduart Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Tiranë. Për paraqitjen e z. Iljan Gjergji Nastu, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore bashkia Korçë dhe pastaj kemi për z. Ismail Bujar Jakupi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

bashkia Durrës. Dhe e fundit nga Komitetet Nismëtare z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore bashkia Korçë. Janë të bashkisë Korçë këtu. Këto janë të gjitha çështjet në rendin e ditës.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumemërore që duhet të paraqesin subjektet zgjedhore këto zgjedhje.

Z. Y. Merkaç: Falemiderit! Referuar neni 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit dhe KAS-it. Për sa më sipër kemi përgatitur aktin për këtë projektvendim, për caktimin e numrit të kandidatëve, për anëtarë të këshillit bashkiak në listën shumemërore të paraqitur nga subjektet zgjedhore, për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Përmbledhja shpjeguese e projektaktit referuar nenit 67, pika 1, të Kodit Zgjedhor “Partitë politike e koalicionet pasi janë regjistruar në KQZ si subjekte zgjedhore depozitojnë listat shumemërore të kandidatëve, për anëtarë të këshillit bashkiak për çdo zonë zgjedhore.

Neni 67, pika 4, e Kodit Zgjedhor parashikon se, “Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të përpjestohet me numrin tre”.

Gjithashtu neni 67, pika 6, e Kodit Zgjedhor parashikon se, “Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra të listës shumemërore

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023**

duhet t'i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar, kurse në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Mospërmbushja nga subjektet zgjedhore e një prej kushteve të parashikuara në nenin 67, pika 7, *passjell refuzimin e listës shumemërore për t'u regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*. Në vlerësim të dispozitave të mësipërme, numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mundet të jetë më i vogël se numri mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse.

Gjithashtu, po në kuptim të dispozitës së nenit 67, pika 6, e Kodit Zgjedhor, lista shumemërore duhet të respektojë kuotën gjinore. Kjo do të thotë që numri i kandidatëve burra dhe gra duhet të jete i barabartë dhe i njëpasnjëshëm në renditje. Respektimi i barazisë gjinore detyron paraqitjen e një liste shumemërore që mbyllet me një numër rendor çift. Nga ana tjetër, neni 67, pika 4, e Kodit Zgjedhor, përcakton se numri i kandidatëve në listë shumemërore ka edhe një kufi të sipërm. Sipas kësaj pike, ky numër është shtuar dy më shumë se numri i mandateve në zonën zgjedhore, por në çdo rast duhet të jetë i plotëpjestuar me 3 (tre). Nëse do të respektonim në mënyrë rigorozë këtë përcaktim, atëhere do të duhej të mos respektonim kuotën gjinore e cila në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, është një rregullim i posaçëm i cili ka prioritet mbi rregullin e përgjithshëm. Për këtë arsye, për të respektuar parimin e përcaktimit të kufirit të sipërm të listës shumemërore, si dhe kushtin e barazisë gjinore konkludohet se, numri i kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve të zonës zgjedhore, dhe kufiri i sipërm i listës së kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak është numri i mandateve të zonës zgjedhore, shtuar me 1 (një). Bashkëngjitur kemi vendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, me pak fjalë ideja është për të qartësuar një interpretim të dispozitave, të disa dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe për të evituar ndonjë pasaktësi. Numrin e kandidatëve në listën shumemërore të cilat do të paraqiten nga çdo subjekt zgjedhor për çdo bashki.

Dhe kemi: për Beratin duhet të jetë 32, për Kuçovën 22, për Poliçanin 16, për Skraparin 16, Dimal 22, Bulqiza 22, Dibër 32, Klos 22, Mat 22, Durrës 52, Krujë 32, Shijak 22, Belsh 22, Cërrik 22, Elbasan 52, Gramsh 22, Librazhd 22, Peqin 22, Prrenjas 22, Divjakë 32, Fier 52, Lushnjë 42, Mallakastër 22, Patos 22, Roskovec 22, Dropull 22, Gjirokastër 32, Këlcyrë 16, Libohovë 16, Memaliaj 16, Përmet 16, Tepelenë 16 dhe Devoll 22. Pra, për të mos u konfunduar ky është numri në listën shumemërore që duhet të paraqesin partitë politike. Numri i mandateve për çdo bashki është një më pak se ky numri që lexuam ne. Dhe ndërkohë rradhitja duhet të jetë praktikisht burrë-grua, mashkull-femër, pra 50% e kandidatëve në listë duhet të jenë të njëjës gjini dhe 50% të gjinisë tjetër, por të alternuar me njëri-tjetrin. Besoj që do të jetë e qartë.

Vendim nr. 100

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan CELIBASHI**
- **Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja**
- **Të Tjerë:** **Z. A. Oldashi, Z. R. Keta, Znj. A. Qefalia
Znj. G. Canollari, Z. E. Mahmuti, Z. J. Dedej, Znj. A. Dervishaj, Znj. O. Abdia
KRIIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, “Mbi shqyrtimin administrativ të veprimtarisë së institucionit, në fakt ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike”. Po Madalena!

Znj. M. Koja: Atëhere, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie nga organizata KRIIK, për disa veprimtari të zhvilluara nga disa institucione publike të cilat nuk janë raportuar në “Ndërfaqen e Raportimeve” në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Është kryer hetimi i plotë administrative duke kërkuar informacion të hollësishëm nga ana e institucioneve. Konkretisht: Ministria për Evropë dhe Punët e Jashtme, Ministrin e Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, Bashkia Cërrik, Bashkia Shkodër, Bashkia Vlorë, Bashkia Libohovë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Tepelenë,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Bashkia Dibër dhe Bashkia Belsh. Referuar edhe pretendimeve të paraqitura nga institucionet, në vlerësimin tonë konkludohet që nga ana e institucioneve ka patur paqartësi në lidhje me karakterin publik të veprimtarive të zhvilluara nga ana e tyre. Mund të përmend disa veprimtari të tilla si: “Dhënie Tituj Nderi nje grupi muzikor italian (Riçi e Poveri)”, “Dhënie Tituj Nderi për një poete në Bashkinë Tepelenë”, “Takim në zyrën e Kryetarit të Bashkisë me disa të rrinj pa prezencë të medias dhe pa qenë i hapur për publikun për pjesëmarrje”, “Përkujtimore e dëshmorëve në Bashkinë Libohovë”. Në këto kushte ne konkludojmë, që për sa kohë ka patur paqartësi nga ana e tyre mbi natyrën publike, mendojmë ta pushojmë procedimin administrative ndaj personave përgjegjës për raportim. Por, nga ana tjetër tërheqim vëmëndjen institucioneve që të marrin masa të menjëhershme, të raportojnë çdo lloj veprimtarie, më pas është në kompetencë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të gjykuar mbi natyrën publike apo jo të veprimtarive. Dhe për këto institucione të listuara më lart pra, sygjerojmë të pushohet procedimi administrative ndaj personave përgjegjës.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Dakord edhe pse e vlerësojmë skrupolozitet e KRIIK, për të qëmtuar çdo parregullsi, qoftë kjo edhe të karakterit formal në veprimtarinë e institucioneve publike dhe në përgjegjësinë e personave për ta bërë këtë, mendoj që referuar natyrës së aktiviteteve për të cilat qartësisht nuk është bërë raportimi i tyre, edhe unë besoj që nuk i vendos në pozitën për tu sanksionuar, por do të duhet t’ja u sjellim në vëmëndje, që çdo lloj veprimtarie panvarësisht dhenie tituj nderi apo dhënie dekoratash, apo aktivitete tërësisht me karakter informativ, apo kulturor duhet të raportohen brenda afatit nëse ato janë publike.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Mendoj që këtë herë të sjellim thjesht dhe vetëm në vëmëndje të tyre pikërisht këtë sqarim, pa nevojën për të vendosur sanksion administrativ. Dakord vazhdojmë më tej.

Vendim nr. 101

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



08.03.2023

Ora 11:24

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për mosraportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan CELIBASHI**
- Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja**
- Të Tjerë: **Z. A. Olldashi, Z. R. Keta, Znj. A. Qefalia
Znj. G. Canollari, Z. E. Mahmuti, Z. J. Dedej, Znj. A. Dervishaj, Znj. O. Abdia
KRIIK**

Z. I. Celibashi: Dakord, vazhdojmë më tej!

Znj. M. Koja: Ndërkohë vijon hetimi administrativ dhe janë njoftuar për seancën e sotme publike disa institucione: Prefekti i Qarkut Gjirokastrë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit për një veprimtari publike të paraportuar, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen për 2 veprimtari publike të paraportuara, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Pogradec, Bashkia Përmet, Bashkia Elbasan, Bashkia Fier, Bashkia Librazhd, Bashkia Bulqizë, Bashkia Prrenjas, Bashkia Roskovec dhe Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Pak para seancës kemi marr dy kërkesa, janë administruar kërkesat nga Qëndresa Qytetare, për të shtyrë shqyrtimin administrativ ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale dhe nga Bashkia Gjirokastrë për të shtyrë shqyrtimin administrativ, pasi e kanë të pamundur për arsye objektive për të qenë sot për të dhënë shpjegimet e tyre. Ndërkohë, objekti i këtyre shqyrtimeve administrative ka të bëjë, nga njëra anë për veprimtari publike të paraportuara dhe për keqpërdorim të burimeve publik për vënien e tyre në dispozicion të politikës të fushatës së ardhshme elektorale. Do jenë të pranishëm sot institucione, do të bëjmë listprezencën kush janë të pranishëm në vijim.

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë faleminderit! Atëhere, për 2 nga institucionet, Ministria e Shëndetësisë dhe Bashkia Gjirokastrë për të cilat organizata Qëndresa Qytetare ka kërkuar të shtyhet seanca e shqyrtimit administrativ, do e pranojmë këtë si kërkesë dhe do të caktojmë një ditë tjetër për të vazhduar me këtë shqyrtim për këto dy institucione. Ndërkohë nga lista tjetër që mbetet, nuk e di se unë nuk i njoh me përjashtim të Andjusit që e njoh që vjen nga Bashkia Fier.

Znj. M.Koja: Po është Bashkia Fier. Është dhe Prefekti i qarkut Gjirokastrë. Janë dhe personat me autorizim të pranishëm sot në seancën dëgjimore.

Z. I. Celibashi: Dakord, ja japim fjalën sipas rradhës, Andjusi fillimisht dhe pastaj më tej.

Z. A. Olldashi: I nderuar Kryetar, përsa është kërkuar nga ana juaj dhe në materialin e paraqitur, Bashkia Fier është denoncuar për një takim të zhvilluar i titulluar “Tryezë diskutimi me komunitetin, në njësinë Mbrostar, për problematikat e zonës”.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Sipas asaj që është paraqitur presupozohet që aktiviteti nuk është deklaruar, por në fakt në Ndërfaqen aktivitetin e kemi deklaruar. Pra, aktiviteti është deklaruar në datën 31.01.2023 dhe është zhvilluar në datën 04.02.2023, pra deklarimi është bërë sipas afatit të përcaktuar nga vendimi 9, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vitit 2020, është zhvilluar në ditë të shtunë, është zhvilluar në një ambjent privat, nuk është zhvilluar në një ambjent publik që është në pronësi të bashkisë, nuk ka qënë i hapur për median. Ne e kemi deklaruar që pjesëmarrës mund të ishte çdo deputet i qarkut Fier, apo edhe çdo deputet tjetër, i cili do kërkonte që të ishte pjesëmarrës në këtë aktivitet. Në aktivitet ka marr pjesë Taulant Balla, i cili është deputet i Kuvendit të Shqipërisë, por që ka dhe një detyrë specifike të ngarkuar nga Partia Socialiste me qarkun Fier, si përfaqësues i saj. Në takim, takimi realisht është zhvilluar në datën 4, dhe jo në datën 19 siç është shkruar në dënoncimin i cili ka ardhur pranë jush. As në vendimin numër 9, as në Kodin Zgjedhor, por as në ndonjë aktë të nxjerrë nga ana juaj ne nuk gjejmë një detyrim që duhet të bëjmë me patjetër publikimin në datën e takimit. Takimin e kemi zhvilluar në datën 4, publikimin sipas strategjisë tonë e kemi hedhur më vonë dhe rezultoi që është hedhur në datën 19, por edhe data 19, është përsëri një ditë pushimi, është e dielë në mos gaboj. Kështu që përse i përket pjesës procedurale të afatit besoj që ne raportimin e kemi kryer, e kemi bërë dhe gjykoj që jemi në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të vendimit numër 9. Përse i përket pjesës tjetër e cila edhe për të sqaruar edhe një gjë në këtë pikë i nderuar Komisioner, në takimin e zhvilluar në datën 4, kanë qënë edhe monitorues të caktuar nga KQZ-ja. Konkretisht unë njoh njërin prej tyre, ka qënë Z. Florian Duraj i cili ka qënë pjesëmarrës dhe ka bërë vëzhgimin e takimit. Pra, fakti i datës 4, që takimi është zhvilluar në datën 4, besoj se me një informacion i kërkuar këtij monitoruesi jam i bindur që do të vertetohej edhe nga ana juaj që takimi është zhvilluar realisht në datën 4. Sa i përket pjesës së mediatizimit është

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

hedhur në datën 19, por është hedhur në faqen personale të Kryetarit të Bashkisë dhe ka bërë një shpërndarje dhe deputeti Taulant Balla. Siç u thashë në faqën zyrtare të bashkisë e cila është e regjistruar në websiten e saj ne nuk kemi hedhur ndonjë postim . Edhe për të mbajtur dhe për të qenë korrekt me dispozitat e ligjit, pasi në takime të tilla pavarësisht se fjala e Kryetarit të Bashkisë ka qenë shumë korrekte dhe është folur kryesisht për ato çfarë është dëgjuar në dëgjesat e kërkuara gjatë muajve tetor-nëntor me komunitetin dhe është bërë një diskutim për problematikat realisht që ka komuniteti. Kryetari i Bashkisë ka qenë shumë i kujdesshëm në fjalën e tij që të mos shprehi dhe të mos bëjë asnjë promovim të ndonjë projekti konkret i cili do të zhvillohej në këtë periudhë zgjedhore, që është periudha 4-mujore përpara ditës së zgjedhjeve. Por, edhe në fjalën e tij siç mund të shihet qartë nuk ka ndonjë premtim, nëqoftëse quhet një falenderim për pjesëmarrjen që ka qenë atje politik nuk e di sepse thuhet “Shumë faleminderit të gjithëve për këtë pjesëmarrje fantastike” . Ka shprehur një krenari për punët e kryera deri në atë moment dhe duke thënë që kemi akoma shumë për të bërë, dua t’ju sqaroj që praktika e bashkisë Fier gjithë këtë periudhë, nuk është se bashkia Fier e ka filluar publikim në faqen zyrtare të Kryetarit apo në faqen zyrtare të saj të vetën në këtë periudhë përpara zgjedhjeve . Kjo është një praktikë që ne e ndjekim në vazhdimësi edhe në funksion të strategjisë së PR që ka filluar bashkia dhe përsëri nuk shikoj në atë që është shkruar, që veprimtaria të ketë pasur një karakter të ndaluar apo të jetë shprehur në ndonjë pjesë e ndaluar nga ato që parashikon vendimi numër 9. Përsa i përket fjalës së Z. Balla nuk do të ishte as etike, as e nderhme por nuk e kishin as mundësinë faktike që në momentin që një deputet që përfaqëson Kuvendin e Shqipërisë, ti ndërpresim fjalën, apo ti themi stop se po flet këtë, apo atë por gjithsesi dhe pjesa e fjalës së Taulantit nuk është se ka bërë ndonjë promovim konkret por është thënë për punët që janë bërë përpara

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

periudhës 4 mujore të zgjedhjeve. Kështu që këto kishim ne si sqarime në lidhje me kërkesën e paraqitur pranë jush. Falminderit.

Z. I. Celibashi: E kuptoj, prania e deputetit Balla jua ka komplikuar disi nga pikëpamja formale ligjore këtë çështje por atëherë Andjus , për ju dhe për këdo tjetër në pozicionin tuaj institucional të institucionit, dua të sjell edhe njëherë në vëmendje qe duhet të ketë një dallim të qartë ndërmjet natyrës së veprimtarive që zhvillon Kryetari i Bashkisë, Ministri apo edhe kushdo tjetër funksionar publik dhe është shumë e lehtë për tu bërë ky dallim dhe kufiri është shumë i qartë për tu ndarë. Nëse është një veprimtari që zhvillohet brenda kompetencës dhe përgjegjësiive institucionale të titullarit, ata janë të lirë ta bëjnë këtë, kanë detyrimin ta raportojnë publikisht nëse kjo veprimtari është publike , me pjesëmarrjen e publikut ose të medias, por në mënyrë kategorike në këto veprimtari nuk ka pse të ketë prezencë të deputetëve apo të përfaqësuesëve politikë. Ose nëse janë deputetë sepse edhe ata janë përfaqësues të shtetit, do të duhet që qëndrimi i tyre, apo presenca e tyre do të duhet që të lidhet thjesht edhe vetëm me funksionin e tyre edhe me përkatësinë e tyre si deputetë të zonës, apo të lidhur me zgjedhësit e asaj njësie ku zhvillohet veprimtaria publike. Përndryshe, një veprimtari e zhvilluar jashtë këtyre kushteve do të konsiderohet si keqpërdorim i aseteve publike. Nëse do të duhet që të themi përsëri i njëjti Kryetar Bashkie, po marr rastin e Kryetarit të Bashkisë, ka nevojën të shfaqet politikisht, këtë është i lirë ta bëjë nuk ka asnjë lloj pengese, por nuk do të duhet të angazhojë në mënyrë kategorike, as nëpunës të bashkisë, dhe as të ndonjë komponenti tjetër të resorsit publik në lidhje me kur zhvillon këtë aktivitet. Kufiri është kaq i qartë sa do të më dukej vërtetë çudi dhe pa sens nëse dikush pa asnjë arsye do ta përziejte interesin e vet politik le të themi me ushtrimin e përgjegjësisë si Kryetar Bashkie. Nga ajo çfarë ju thatë kuptova që aktiviteti ka qenë politik.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Z. I. Celibashi: Nga ajo çfarë ju thatë kuptova që aktiviteti ka qenë politik, më duket sikur thatë. Gjithsesi ngelet për tu parë...

Z. A. Olldashi: ka qenë aktivitet, nuk thash aktivitet politik. Ka qenë pjesëmarrja e zotit Taulant Balla i cili ndoshta i ka dhënë një konatacion politik por fjala e Kryetarit të Bashkisë ka qenë strikt vetëm për punët dhe në lidhje me çfarë është thënë dhe është marrë nga dëgjesat e mëparshme.

Z. I. Celibashi: Shumë e qartë! Ndërsa për aktivitetet me karakter politik nuk keni asnjëlloj detyrimi për të raportuar. Takoni elektorat, zhvilloni takime me deputet a me Kryetarin e Partisë, të Partis Socialiste apo të Partisë aty në qark apo në rreth. Nuk ka asnjëlloj detyrimi për të bërë raportime të tilla. Por kur janë veprimtari me karakter institucional është e këshillueshme, është e detyrueshme në fakt në ligj që ato të zhvillohen strikt në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Dakort?

Z. A. Olldashi: Dakord.


Z. I. Celibashi: Ndërkohë, ne do të bëjmë një vlerësim të asaj çfarë ju thatë, si dhe të materialit që janë paraqitur dhe do të disponojmë me vendim.

Z. A. Olldashi: Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Rradha? Nuk e di tani! Nga institucionet që janë të listuara kush është prezent mund ta marri fjalën se thashë që nuk ju njohim.

Znj. M. Koja: Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*


Z. E. Mahmuti, përfaqësues i prefekturës Gjirokastrë: Në datën 30 janar pranë universitetit “Eqerem Çabej” është mbajtur një dëgjese publike në lidhje me shpalljen e lumit Vjosa si Park Kombëtar. Ashtu siç ju kemi sqaruar edhe në emailin e datës 14 shkurt. Kjo dëgjese publike organizohet nga Ministria e Turizmit dhe nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Normalisht duke mos qenë një institucion organizator ne nuk kemi pasur arsye pse ta raportonim në ndërfaqen e KQZ-së. Pra ne jemi thjesht, nëqoftëse do të shohim shkresën që na ka ardhur nga Ministria e Turizmit, ne jemi thjesht të ftuar ashtu siç ka qenë dhe Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Libohovë, Bashkia Dropull. Pra ne jemi njësoj si të gjitha institucionet e tjera dhe nuk jemi një institucion organizator. Normalisht në ndërfaqen e KQZ-së do të raportohet institucioni organizator, të ftuarit, datën etj... Pra normalisht këtë nuk mund ta bënim. Gjithashtu deri në datën 28 shkurt ne akoma nuk kemi pasur llogari në ndërfaqen e KQZ-së. Ne në 28 shkurt i kemi dërguar KQZ-së një kërkesë për ta hapur llogarinë dhe në 1 mars është hapur llogaria që është loguar personi i kontaktit, nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Z. I. Celibashi: Kur e keni sjellë kërkesën? Në 28 shkurt?

Z. E. Mahmuti, përfaqësues i prefekturës Gjirokastrë: Në 28 shkurt.

Z. I. Celibashi: Edhe në 1 është hapur?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Z. E. Mahmuti, përfaqësues i prefekturës Gjirokastrë: Po! Në 28 shkurt është dërguar në orën 15:38 nga personi, nga pika e kontaktit dhe në 18 shkurt unë shoh që nga institucioni KQZ është dërguar një specialisti për të dhe thotë “ të lutem të precedohet për të hapur accountin”. Në 1 mars thotë useri u ndryshua nga Nertil Nebiaj nga Arjan Korkuti. Ky personi Nertil nuk është përfaqësues i institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Domethënë ka qenë një gabim a lapsus, nuk e di, i institucionit të KQZ-së. Ne nuk futeshim dot!

Znj. M. Koja: Jo mund të ketë qenë një raportues në 2021 dhe ne i kemi mbartur ato.

Z. E. Mahmuti, përfaqësues i prefekturës Gjirokastrë: Domethënë ne prandaj deri në 1 mars ka qenë e pamundur të logoheshim në ndërfaqen edhe nëqoftëse ne do ishim vërtet organizator ka qenë e pamundur.


Z. I. Celibashi: Dakord. Në 28 e keni bërë kërkesën?

Z. E. Mahmuti, përfaqësues i prefekturës Gjirokastrë: Por jo, dakord, që në dhjetor ne i kemi dërguar KQZ-së pikën e kontaktit. Kemi dërguar të gjitha të dhënat, çdo gjë domethënë. Jua kemi dërguar me shkresë në 14 dhjetor. KQZ-ja ka qenë në dijeni në lidhje me pikët e kontaktit. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit. Kemi përfaqësues të institucioneve të tjera? Nuk kemi!

Znj. M. Koja: Janë për pikën tjetër. Lidhur me takimin e Prefektit Gjirokastrë dhe Ministrisë dhe Agjensisë Kombëtare...

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Z. I. Celibashi: Jo, më fal, është në vijim të kësaj?

Znj. M. Koja: Po!

Z. I. Celibashi: Të çfarë tha zotëria?

Znj. M. Koja: Po!

Z. I. Celibashi: Dakord, në rregull. Lërimi një vend të lutem.

Znj. G. Cenollari: Atëherë unë jam përfaqësuese e Agjencisë Komëtare të Zonave të Mbrojtura e cila ka qenë pjesë e takimit të mbajtur në Gjirokastër. Ky takim është mbajtur në vazhdimësinë e disa takimeve që ka zhvilluar Ministria dhe Agjencia për shpalljen e luginës së Vjosës Park Kombëtar. Takimi ka pasur në fokus prezantimin e planit të shpalljes së Parkut Kombëtar të lumit të egër Vjosa. Me tematikën për argumentimin, për krijimin e zonë së mbrojtur e cila mbështetet nga objektivat e planit kombëtar të rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, vlerat e natyrës dhe të biodiversitetit, vlerën turistike e cila azohet mbi trashëgimnin natyrore dhe identitetin kulturor, zonimin e zotës natyrore si dhe shkallën e mbrojtjes së propozuar për këtë zonë. Në këtë takim ka marrë pjesë Prefekti i Vlorës dhe Gjirokastër, grupet e interesit, institucionet akademike shkencore në vend, komuniteti i zonës dhe pronarët privat nëse prona e tyre do të përfshihet në zonën e mbrojtur. Takim ky i organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Në vijimësi të çfarë tha dhe kolegu i Prefektit të Gjirokastër dua tju bëj me dije se dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka pasur të

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

njëjtën problematikë me personin e kontaktit. Referuar shkresës së dërguar nga ana e KQZ-së që në dhjetor, kërkes për caktimin e personit të kontaktit. Ndër të tjera është thënë që me marrjen në dijeni se kush do të jetë personi i kontaktit për institucionet nga ana e KQZ-së do na dërgohen dhe kredencialet, udhësimet për tu loguar në ndërfaqen e KQZ-së. Ju sqarojmë se personi i caktuar nga ana e Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk ka marë një njoftim nga ana e KQZ-së në lidhje me hapjen e llogarisë së institucionit dhe kredencialet janë dërguar nga ana e KQZ-së në datën 21.02.2023 pas kërkesës të bërë nga ana e institucionit. Për këtë arsye nuk është raportuar në kohë.


Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit!

Znj. G. Cenollari: Ju lutem.

Z. I. Celibashi: Në lidhje me këtë çështje? Diskutim tjer? Nuk kemi. Dakort, mirë, faleminderit! Nga institucione të tjera?

Z. R. Keta: Përshëndetjë, Reald Keta, përfaqësues i autorizuar i Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Jemi bërë me dije me komunikimin elektronik nga administrata e KQZ-së për hetimin administrativ për dy veprimtari të zhvilluara njëra me datë 1 shkurt dhe tjetra me datë 19 janar. Me komunikimet shkresore dhe elektronike më datë 15 shkurt dhe 17 shkurt Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka përcjellë informacionin në lidhje me këto dy veprimtari. Të përbashkëtat e tyre për aq sa mund të them dhe kryesorja është në të dyja rastet Ministri i Shtetit ka qenë pjesëmarrës në veprimtari, nuk ka qenë organizator. Në shkresë bëjmë me dije edhe elementë të tjerë cilësorë por gjithsesi në të dyja rastet

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

siç edhe e cilësova ka qenë pjesëmarrës. Për ekonomizim kohe i qëndrojmë vetëm informacionit të sjellë me shkresë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit Reald! Tjetër, institucion tjetër?

Mirë, atëhere do të bëjmë një vlerësim. Edhe çfarë këtu u prezantua me përfaqësuesit e institucioneve nga dokumentacioni që i është prezantuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve edhe nga kolegët, ish kolegët tuaj të KRIIK-ut dhe do të vendosim. Besoj deri ditën e premte do të kemi vendimin përkatës. Mirë, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

08.03.2023
Ora 11:44

RENDI I DITËS

“Përfundimi i hetimit administrativ mbi raportimet e organeve publike për periudhën 17 shkurt - 23 shkurt 2023”.


PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan CELIBASHI**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja**
- **Të Tjerë: Z. A. Olldashi, Z. R. Keta, Znj. A. Qefalia
Znj. G. Canollari, Z. E. Mahmuti, Z. J. Dedej, Znj. A. Dervishaj, Znj. O. Abdia
KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Znj. M. Koja: Atëherë në rend të ditës vijojmë Komisioner me shpalljen e vendimit për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve për periudhën 17 shkurt – 23 shkurt 2023. Konkretisht ne propozojmë pushimin e procedimit administrativ ndaj këtyre institucioneve. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, Ministri i Shtetit për Marëdhëniet me Parlamentin, Banka e Shqipërisë, Muzeu Historik Kombëtar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë, Agjencia Kombëtare e Formimit Profesional, Shërbimi i Provës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Bashkitë Kurbin, Lezhë, Mat, Roskovec, Sarandë, Shkodër dhe Tepelenë. Argumentet e dhëna nga ana e këtyre institucioneve

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

qëndrojnë dhe për këtë arsye mendojmë të mos procedojmë më tej, ta përfundojmë këtu shqyrtimin administrativ. Por ndërkohë sugjerojmë t'i tërhiqet vëmendje Bashkive Lezhë, Mat, Sarandë dhe Shërbimit të Provës për të marë masa të menjëhershme për të raportuar veprimtaritë publike brënda afatit ligjor.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord me këtë vlerësim edhe me këtë rekomandim në lidhje me vendimmarrjen për këto raste.

Vendim nr. 102

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

08.03.2023
Ora 11:46

RENDI I DITËS

“Vlerësim i raporteve të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, qendrore dhe vendore si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, për periudhën 24 shkurt – 2 mars 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan CELIBASHI**
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj.
- **Të Tjerë:** Z. A. Olldashi, Z. R. Keta, Znj. A. Qefalia
Znj. G. Canollari, Z. E. Mahmuti, Z. J.
Dedej, Znj. A. Dervishaj, Znj. O. Abdia
KRIIK

Z. I. Celibashi: Kemi edhe periudhën 24 shkurt – 2 mars 2023.

Znj. M. Koja: Po! Në total janë raportuar 319 veprimtari nga 72 institucione. Konstatohet se nga këto 57 janë në shkelje të afatit ligjor të raportuara nga 31 institucione. Deri më sot kanë paraqitur pretendimet e tyre rreth 22 institucione. Ne i kemi ftuar edhe sot në seancë dhe nëse kanë ndërmend të japin shpjegime të tjera ato janë të ftuar për të qenë sot të pranishëm. Dhe në përfundim do të dalim me vendimmarrjen ditën e premte siç e kemi në kalendar.

Z. I. Celibashi: Po, dakord. Ka përfaqësues të institucioneve? Po!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

Znj. A. Qefalia : Përshëndetje, quhem Albana Qefalia dhe jam personi i kontaktit nga Prefekti i Qarkut Tiranë. Në datën 3 mars Prefekti i Qarkut Tiranë ka qenë i ftuar nga Bashkia Rrogozhinë për një aksion pastrimi. Si zakonisht jemi munduar të bëjmë raportimin 5 ditë para. Ditën e hënë në datën 27 shkurt por në mungesë të kredincialeve nuk kemi mundur dot të raportojmë. Kemi kontaktuar personin e kontaktit nga KQZ-ja dhe jemi informuar që duhet te dërgojmë një email ku të kërkojmë passwordin për tu loguar. E kemi dërguar emailin, kemi dërguar edhe një email të dytë ditën në vazhdim për shkak se nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Dhe ditën e mërkurë në datën 1 mars janë paraqitur fizikisht pranë ambjenteve të KQZ-së për tu informuar rreth këtij problemi. Jemi paraqitur në zyrën juridike dhe na kanë informuar që emailin që kemi dërguar duhet ti kishim dërguar në një adresë tjetër por që ne nuk jemi vënë në dijeni për adresën tjetër. Kemi vazhduar me të njëjtën adresë që kemi pasur edhe më parë nga e cila kemi marrë edhe passwordin e fundit për tu loguar. Më pas kemi bërë të mundur në datën 1 mars të bëjmë raportimin si dhe kemi dërguar një email shpjegues lidhur me situatën. Kjo është problematika që ne nuk kemi mundur dot të raportojmë 5 ditë para por 3 ditë para. Gjithsesi dua të specifikoj që nuk është një aktivitet që do të zhvillohej nga Prefekti i Qarkut Tiranë. Në kemi qenë të ftuar nga Bashkia Rrogozhinë. Por duke qenë se Bashkia Rrogozhinë është pjesë e Qarkut Tiranë, Prefekti i Qarkut Tiranë herë pas here demonstroi edhe punën në faqen zyrtare. Ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Përtej kësaj vlen edhe në rastin tuaj për ta pasur në vëmendje çfarë thashë pak më herët për një dallim të qartë ndërmjet natyrës së veprimtarive që zhvillojnë përfaqësuesit e institucioneve publike. Në këtë rast edhe te Prefektit. Nuk ka asnjëlloj ndalimi që Prefekti në cilësinë e tij të marrë pjesë në aktivitete të institucioneve të tjera, nuk ka asnjëlloj ndalimi, apo edhe në aktivitete


*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

të vetat të cilat ai i vlerëson që t'i zhvillojë në kuadër të kompetencës së tij. Por kur është si Prefekt duhet të sillet si Prefekt. Nuk është vetëm për Prefektin e Qarkut Tiranë vlen edhe për këdo funksionar tjetër pulik. Dhe kur do të sillet si funksionar politik është i lirë ta bëj këtë por pa pasur angazhime të stafit të Prefekturës të themi në rastin konkret apo edhe asete dhe resurseve të tjera publike. Mirë, faleminderit. Institucione të tjera? Nuk kemi! Dakord! Mirë e mbyllim edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe duke rikujtuar që do të bëjmë një vjerësim të materialeve që disponon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve por edhe të deklarimit që kanë bërë përfaqësuesit e institucioneve publike në lidhje me pretendimet e ngritura nga të tretë të tjerë. Dakord, mirë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesës së partive politike, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike: Partia ABDE, Partia PDIU, Partia PL**
- **Të tjerë: KRIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me regjistrimin e disa partive politike si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e 14 majit 2023.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur kërkesat për regjistrimin e subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të partive politike si më poshtë:

- “Partia Socialdemokrate”
- “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”
- “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”
- “Partia e Gjellbër”
- “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”
- “Partia Ora e Shqipërisë”
- “Partia Kombëtare Konservatore Albania”
- “Aleanca Arbnore Kombëtare”
- “Partia Demokristiane e Shqipërisë”

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

- “Partia Emigracioni Shqiptar”
- “Partia Komuniste e Shqipërisë”
- “Partia Qytetare Shqiptare”
- “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen MEGA”
- “Partia Republikane Shqiptare”
- “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”
- “Partia Shqiptare Atdheu”
- “Partia Uniteti Kombëtar”
- “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”
- “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”
- “Lëvizja Punëtore Shqiptare”
- “Nisma Thurje”
- “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”
- “Balli Kombëtar Demokrat”
- “Partia Konservatore”
- “ Lëvizja e Re”
- “Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë”
- “Aleanca Demokracia e Re”
- “Partia Balli Kombëtar”
- “Partia Demokracia Sociale”
- “Personat me Aftësi të Kufizuar”
- “Aleanca Demokratike Shqiptare”
- “Lëvizja e Legalitetit”
- “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”
- “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”
- “Bashkimi Liberal Demokrat”

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

- “Ardhmëria Shqiptare”
- “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”,
- “Partia Fryma e Re Demokratike”
- “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”
- “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”
- “Fronti i Majtë”
- “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”


Kërkesat e partive politike për regjistrimin e subjektit zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023 respektojnë afatet e parashikuara nga neni 64, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu bashkëlidhur kërkesës kanë paraqitur edhe dokumentacionin vijues për të gjitha rastet si më poshtë:

- Vërtetimi i lëshuar nga zyra e regjistrimit të partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Deklarata e angazhimit solem model KQZ 04/02.
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike model KQZ 04/03.

Dokumentacioni i paraqitur nga partitë politike është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të neneve të mësipërme i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve regjistrimin e partive politike si subjekte zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 sipas listës bashkëlidhur vendimit dhe të cilën e përcaktuam më lartë. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Atëhere meqenëse dokumentacioni që ka dorëzuar secila prej këtyre partive është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor të ligjit për partitë politike, miratojmë regjistrimin si subjekt zgjedhor të këtyre partive politike:

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

- “Partia Socialdemokrate”
- “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”
- “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”
- “Partia e Gjelbër”
- “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”
- “Partia Ora e Shqipërisë”
- “Partia Kombëtare Konservatore Albania”
- “Aleanca Arbnore Kombëtare”
- “Partia Demokristiane e Shqipërisë”
- “Partia Emigracioni Shqiptar”
- “Partia Komuniste e Shqipërisë”
- “Partia Qytetare Shqiptare”
- “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen MEGA”
- “Partia Republikane Shqiptare”
- “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”
- “Partia Shqiptare Atdheu”
- “Partia Uniteti Kombëtar”
- “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”
- “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”
- “Lëvizja Punëtore Shqiptare”
- “Nisma Thurje”
- “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”
- “Balli Kombëtar Demokrat”
- “Partia Konservatore”
- “Lëvizja e Re”
- “Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë”

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

- “Aleanca Demokracia e Re”
- “Partia Balli Kombëtar”
- “Partia Demokracia Sociale”
- “Personat me Aftësi të Kufizuar”
- “Aleanca Demokratike Shqiptare”
- “Lëvizja e Legalitetit”
- “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”
- “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”
- “Bashkimi Liberal Demokrat”
- “Ardhmëria Shqiptare”
- “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”
- “Partia Fryma e Re Demokratike”
- “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”
- “Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë”
- “Fronti i Majtë”
- “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”

Për partitë e tjera do të vazhdojmë nesër shqyrtimin e kërkesave, kështu e kemi lënë.

Vendime nr. 103-144

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e Komiteteve Nismëtare, që do të organizojnë punën për paraqitjen e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore të Bashkive Korçë, Tiranë, Durrës, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** **Z. Ilirjan CELIBASHI**
- **Stafi KQZ:** **Z. Y. MERKAJ, Znj. M. KOJA,**
- **Parti Politike:** **Partia ABDE, Partia PDIU, Partia PL**
- **Të tjerë:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëhere vazhdojmë me kërkesat për regjistrimin e Komiteteve Nismëtare të cilat do të zhvillojnë procedurat dhe do të organizojnë punën për paraqitjen e kandidatëve për Kryetar Bashkie ose ndoshta dhe për anëtar të Këshillit Bashkiak të propozuar nga zgjedhësit. (shkurt në lidhje dhe me këtë)

Z.Y.Merkaj: Katër grupe zgjedhësish nga zona zgjedhore të ndryshme kanë paraqitur kërkesën për regjistrimin e Komiteteve Nismëtare për organizimin e punës për paraqitjen e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, Bashkia Korçë, Bashkia Durrës dhe Bashkia Korçë. Kërkesat e paraqitura respektojnë afatin e parashikuar në nenin 70 të Kodit Zgjedhor. Kërkuesit kanë depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës edhe kopje të dokumentacionit të identifikimit. Nga verifikimi i emrave të kërkuesve

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

në ekstrakt e kërkesit zgjedhor rezulton së janë zgjedhës të zonave zgjedhore përkatëse dhe me vullnetin e tyre të lirë kanë vendosur krijimin e një Komiteti Nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin e propozuar nga zgjedhësi. Në mbështetje të neneve të mësipërme i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve regjistrimin e Komiteteve Nismëtare për organizimin, për mbledhjen e firmave për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Për zotin Lazgjon Vangjel Pjetri kandidat i Bashkisë Korçë, për zotin Eduart Muhamet Nallbani kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Bashkinë Tiranë, për zotin Iljan Gjergji Nastro kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Bashkinë Korçë dhe zotin Ismail Bujar Jakupi kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Bashkinë Durrës. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëhere mëqenëse dhe dokumentacioni i paraqitur nga këto Komitete Nismëtare është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, miratojmë kërkesat:

- Për regjistrimin e Komunitetit Nismëtar që do organizojë punën për paraqitjen e zotit Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Bashkinë Tiranë.
- Për regjistrimin e Komunitetit Nismëtar që do organizojë punën për paraqitjen e zotit Iljan Gjergji Nastro kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Bashkinë Korçë.
- Regjistrimin e Komunitetit Nismëtar që do organizojë punën për paraqitjen e zotit dhe zotit Ismail Bujar Jakupi kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zonën zgjedhore Bashkia Durrës.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.03.2023*

- Regjistrimin e Komunitetit Nismëtar që do organizojë punën për paraqitjen e zotit dhe zotin Lazgjon Vangjel Pjetri kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zonën zgjedhore po Bashkia Korçë.

Këto kemi! Pikë tjetër në rendin e ditës? Nuk kemi.

Mirë, faleminderit. Seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

